KOMUNIKATË PËR MEDIA

Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi,TM1 2024

03.05.2024

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Indeksin e Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi për tremujorin e parë (TM1) 2024

Rritet indeksi i përgjithshëm i prodhimeve bujqësore në TM1 2024, krahasuar me TM1 2023

Ky publikim është i bazuar në grumbullimin e çmimeve të prodhimeve bujqësore vendore në Kosovë. Grumbullimi i të dhënave është bërë në treg, ferma dhe vendet të tjera, ku çmimet e prodhimeve bujqësore mund të grumbullohen.

Indeksi i çmimeve të prodhimeve bimore, blegtorale dhe totali i prodhimeve bujqësore TM1 2020-2024, (2020=100)



Në TM1 2024, indeksi i çmimeve të prodhimeve bimore ka rritje për 2,8%, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023. Indeksi i çmimeve të prodhimeve blegtorale ka rritje për 7,3%.

Indeksi i përgjithshëm i prodhimeve bujqësore ka rritje për 5,3%, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023.

Ndryshimi në %, TM1 2024 me TM1 2023

Përshkrimi	TM1 2023	TM1 2024	Ndryshimi në %
Prodhimet bimore	142,2	146,3	2,8
Prodhimet blegtorale	132,9	142,7	7,3
Totali prodhimeve bujqësore	137,0	144,3	5,3

Prodhimet që krijojnë bazë për indeksin e çmimeve të prodhimeve bujqësore janë ndarë në dy grupe kryesore: Prodhimet bimore dhe ato blegtorale. Në kuadër të prodhimeve bimore, çmimet janë grumbulluar për këto grupe: drithëra, bimë foragjere, perime, patate dhe pemë. Në prodhimet blegtorale çmimet janë grumbulluar për blegtorinë dhe prodhimet blegtorale. Në kuadër të blegtorisë, çmimet grumbullohen për katër kategori të kafshëve: gjedhe, dele, derra dhe pula. Këto çmime janë bazuar në peshën e gjallë të kafshëve. Në kuadër të prodhimeve blegtorale çmimet janë grumbulluar për: qumësht, vezë dhe mjaltë. Të gjitha çmimet janë llogaritur në Euro dhe njësitë matëse janë në: kg, litër dhe copë.

Për më shumë informata lidhur me Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi, për TM1 2024 (2020=100), vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/Agriculture